REPUBLIKA E KOSOVËS
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJE
NË LIDHJE ME AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

C-II-16-0679 – C 0001

Paditës: H S, nga Prishtina

Kundër

I paditur: NSH "T " Prishtinë e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), rr. "Agim Ramadani'' nr. 23, Prishtinë

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimi me gjyqtarin Hasim Sogojeva, me 06 prill 2021, mori këtë:

A K T V E N D I M

Padia e paditësit, konsiderohet e tërhequr.

Rrethanat Faktike dhe Procedurale

Me 06 dhjetor 2016, pranë DHPGJS,është pranuarpadiae paditësit, kundër të padituri në lidhje me kompensimin e pagave për periudhën 04 mars 1991 deri më 24 mars 1999 në shumën 5,568€ .

Me 23 janar 2017, AKPpërmes përfaqësuesit parashtroj Mbrojtje ne Padi, me të cilën ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit.

Më dt. 23.02.2021 , Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës , ka lëshuar Urdhër C-II- 16- 0679 – C – 0001, për plotësimin e padisë sikundër edhe për pagesën e taksës gjyqësore për padi .

Urdhëri ju është dorëzuar, familjarit të paditësit N S, më dt. 23.02.2021 .

Arsyetimi ligjor

Padia e paditësit, konsiderohet e tërhequr.

Bazuar në nenin 5.5.2 të Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2017, hyrë në fuqi më 01 maj 2017, për aplikimin e njëjtë të taksave gjyqësore, paditësit i kërkohet që brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga të shërbyerit dhe pranimi i urdhrit të gjykatës për të ia dorëzuar Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës vërtetimin dhe faturën e pagesës të shumës së caktuar që duhet

paguar ose që t'i dorëzojë gjykatës prova në lidhje me faktin se ai është i liruar nga pagesa për arsye se është përfitues i ndihmës sociale nga ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ose Ndihmës Ligjore nga Zyra e Qarkut për Ndihmë Juridike.

Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2017, për unifikimin e tarifave gjyqësore, neni 5 paragrafi 5.1, parashikon detyrimin e të gjithë atyre që i drejtohen Gjykatës për të paguar taksat gjyqësore për procedimin në shumën e duhur, dhe në paragrafin 8 parashikon rastet kur paraqitësi i kërkesës është përjashtuar nga kjo pagesë, dhe paragrafi 8.3 parashikon dokumentet që personat e përjashtuar duhet ti paraqesin gjykatës:

a. Një person fizik jep dëshmi se ai ose ajo është përfituesi i një ndihme sociale nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ose agjencisë që e ka pasuar; ose,

b. Nëse personi paraqet dëshmi se ai ose ajo merr ndihmë juridike nga Zyra e Qarkut për Ndihme Juridike.

Për më tepër, Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2017, Neni 5.5.2 parasheh që, "nëse pas njoftimit, pala nuk i paguan taksat gjyqësore, sipas nenit 5.1 të këtij udhëzimi, gjyqtari i caktuar për çështjen, do të aplikojë nenin 253, paragrafi 5 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore dhe si pasojë padia do të konsiderohet e tërhequr.

Paditësi përmes urdhrit për pagesën e taksave gjyqësore u informua për faktin se në bazë të nenit të lartpërmendur të Udhëzimit Administrativ, në rast të mos pagesës, ose në rast të mos paraqitjes në gjykatë, brenda afatit të caktuar prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, dëshmi se është përfitues i së drejtës për t'u liruar nga pagesa, Gjykata do të marrë një vendim duke e konsideruar çështjen në fjalë si të tërhequr.

Meqenëse paditësi, kishte pranuar urdhrin për pagesën e taksës, gjyqësore dhe kjo rrethanë vërtetohet nga nënshkrimi familjarit N S më dt. 23.02.2021, ku pohon se kam pranuar Urdhërin, i njëjti nga ajo kohë e deri në ditën e marrjes së vendimit nuk e ka dorëzuar dëshminë për pagesën e taksës gjyqësore, sikundër nuk ka ushtruar as kërkesë për lirim nga pagesa për taksë gjyqësore, kështu që në kuptim të dispozitës së nenit 253.5 të LPK-së, gjykata padinë e paditësit e konsideroi të tërhequr .

Për këtë arsye u vendos si në dispozitiv.

<u>Këshillë Juridike:</u>

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga pranimi i këtij aktvendimi.

Hasim Sogojeva, Gjyqtar